

20081031973

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKES SË MAQEDONISE ME HUA TE BANKA
NDERKOMBETARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTERORE
SIPAS MARREVESHJES PËR HUAN E TRETË PROGRAMORE PËR POLITIKA
ZHVILLIMORE – PDPL 3

Neni 1

Republika e Maqedonise ngarkohet te Banka Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim - Banka Boterore me hua në shume prej 16.700.000 euro, dedikuar për realizimin e Huas së trette programore për politika zhvillimore - PDPL 3.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për huan e trette programore për politika zhvillimore - PDPL 3, e cila do të lidhet ndermjet Qeverise së Republikës së Maqedonise dhe Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim – Banka Boterore.

Në emer të Republikës së Maqedonise, Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni do ta nenshkruaje ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagimin e huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 17 vjet, me grejs periudhe të perfshire prej 5 vjetesh. Shkalla e interesit sipas së ciles do të servisohet huaja eshte LIBOR (për valuten euro) e zvogeluar për 0,06 %. Shkalla e interesit mund të zvogelohet në baze të vendimit paraprakisht të marre nga Banka Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim - Banka Boterore.

Huaja do të paguhet në 24 keste gjysmevjetore, në çdo 15 shkurt dhe 15 gusht në vit. Prej 15 gushtit 2013 deri më 15 gusht 2024 do të paguhet 23 keste gjysmevjetore, secila në shumen prej 4,17% të huas, gjegjesisht 696.390 euro ndersa më 15 shkurt 2025 do të paguhet kesti i fundit në shume prej 4,09% të huas, gjegjesisht 683.030 euro.

Në grejs periudhen prej 5 vjetesh që paraqet edhe periudhen e realizimit të projektit, do të paguhet vetem interesi i huas.

Me ditën e terheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Boterore provizion të njefishte në shume prej 0,25% të shumes së huas.

Neni 4

Shfrytezuese e mjeteve nga huaja nga neni 1 i ketij ligji eshte Ministria e Financave në emer të Qeverise së Republikës së Maqedonise.

Neni 5

Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonise”.